

RELACION

MBI MIRATIMIN E BUXHETITTE VITIT 2021

Të nderuar anëtarë të Asamblesë Kombëtare

Viti 2021 është viti I dyte I mandatit të dytë të USSH-së. Viti ne vazhdim, si pasoje e pandemise te shkaktuar nga COVIT 19, ka qene nje vit I veshtira, per biznesin ne pergjithesi dhe per stomatologjine ne vecanti. Kjo gje u pasqyrua ne mungesen e te ardhurave te biznesit te tyre, per rrjedhoje edhe ne buxhetin e Urdhrit. Duke pare ecurine e situates parashikohet qe edhe viti 2021, sidomos ne 6 mujorin e pare te kete ngadalesi te aktivitetieve qe mund te reflektohen ne buxhetin e gjithsecilit. Në këtë kuadër, Buxheti I vitit 2021 do të jetë nje sfide per te gjithë nivelet e urdhrit, vendimarrrese, zbatuese apo te antaresise.

BUXHETI I VITIT 2021

1. Objektivat e Buxhetit 2021

Objektiv per buxhetin e vitit 2021 do te jete realizimi i të ardhurave nëpërgjithësi dhe të ardhurat nga kuotat mujore në veçanti, për të krijuar një qëndrueshmëri ne vazhdimesi të ardhurash. Rritja e të ardhurave do të bazohet në Së pari në rritjen e bazës së pagesës pa ndryshuar tarifat Së dyti në rritje e luftës kundër informalitetit.

Detajimi I Buxheti per vitin 2021

Hartimin i buxhetit të vitit 2021, është mbështetur në përvojën e mëparshme, në buxhetet faktike të çdo viti, si për të ardhurat, ashtu dhe për shpenzimet, gjithashtu planifikimi është bazuar si në zbatimin e buxhetit në qendër, ashtu edhe nga Rajonet.

1.1 Planifikimi I te ardhurave

Si bazë për planifikimin e të ardhurave për vitin 2021 ka sherbyer ecuria e realizimit të të ardhura në vite dhe konkretisht :


- realizimi I të ardhurave për periudhën janar-shtator 2020 si dhe I pritshmi deri në fund të vitit,
- realizimi I të ardhurave për vitet 2018-2019
- numri I antarëve të liçensuar dhe të rilicensuar për periudhën 4 vjeçare
- numri I stazhistëve të regjistruar për provimin e shtetit
- nga numri I studenteve qe perfundojne studimet dhe do të fillojnë praktikën një vjeçare

Realizimi I të ardhurave për vitet 2015-2019 paraqitet si vijon:

NR	EMERTIMI	VITET					Parashikimi v. 2020	Parashikimi v. 2021
		VITI 2015	VITI 2016	VITI 2017	viti 2018	Viti 2019		
A	TE ARDHURAT							
I	TE ARDHURA TE TRASHEGUARA							29700
II	TE ARDHURA NGA VEPRIMTARIA							
1	Hapje dosje	3790	3580	3140	2930	2540	1500	2300
2	Licensim	2835	5355	4215	1740	3525	3500	3600
3	Rilicensim	2308	4020	6780	6735	5055	6000	5700
4	Kuote antaresimi	5049	19816	21644	22169	21705	21370	25670
	kuote nga licensimet		3739	2654	983	1853	1770	1850
	kuote nga Rilicensimet		6401	11036	13037	13660	12500	12500
	kuote vjetore		9676	7954	8149	6290	7100	11320
5	Certifikat miresjelljes	430	630	720	900	1020	1200	1200
6	Provimi praktikes	0	590	2560	2060	2780	1460	2500
7	Trajnimi ONL	0	0	75	130	2	0	65
8	Drejtues Teknik	0	0	0	90	30	30	30
	Konferenca	0	0	0	0	426	200	900
9	te tjera	23	35	11	12	38	35	35
	SHUMA II	14435	34026	39145	36766	36930	35295	42000
	Ardhura te tjera	10000			182	0		
	TOTALI TE ARDHURAVE	24435	34026	39145	36948	37111	35295	71700

Viti 2020 parashikohet te kete rezultat te balancuar, te pakten te mos kete humbje.

GrafikIisht realizimi I te ardhurave ne vite paraqitet si vijon:



Si shihet te ardhurat kane nje qendrueshmeri ne vite te cilen jo vetem duhet ta konsolidojme, por te kemi nje trend rrites per te ardhmen. Te ardhurat jane planifikuar me lart se viti ne vazhdim duke u mbeshtetur ne nje detyrim statutor dhe ne vendimin e keshillit Kombetare per arketimin e tarifave mujore dhe jo me vone se nje vit nga data e detyrimit. Ne rast te kundert do te kete penalitete. Nisur nga keto 2 detyrime ligjore, Aparati Qendror qe ne fund te vitit 2020 ka filluar punen per evidentimin e stomatologeve te cilet nuk paguajne detyrimet ritmikisht.

Sic e theksuam dhe me lart, planifikimi I te ardhurave per vitin 2021 eshte mbeshtetur ne ecurine e tyre ne vite dhe nga numri I antareve qe kane kontribuar gjate periudhes.

Te ardhurat nga licensimet Të ardhurat nga liçensimet për vitin 2020 janë realizuar rreth 80 %. Nder vite numri I licensimeve ka kurbën në rënie (nga 357 ne vitin 2015, në 235 ne vitin 2019) Planifikimi I të ardhurave për vitin 2021 eshte planifikuar mbeshtetur ne kete trend me 240 liçensime.

Te ardhurat nga rilicensimet. Planifikimi I të ardhurave për rilicensim është bazuar në ritmikën e rilicensimeve në vite, numri I tyre kulmon ne vitin 2017 me 452 dhe ka trend ne zbritje ne vitet ne vazhdim, deri 337 per vitin 2019.megjithate , per vitin 2021 kemi planifikuar 380 rilicensime duke marre parasysh mungesen gjate vitit 2020.


Te ardhurat nga Regjistrimi Numri I stazhisteve nga viti në vit ka pesuar renie. Nga 379 regjistrime qe jane kryer ne vitin 2015, në 254 per vitin 2019. Nisur nga kjo tendencë, janë planifikuar 230 regjistrime.

Te ardhurat nga provimi i praktikës Për vitin 2018 janë regjistruar 206 praktikantë qe I janë nënshtruar provimit të praktikës nga 256 që kanë marrë pjesë në vitin 2017. Për

vitin 2019 Ne viti 2020 146 stazhist. Janë regjistruar 278 praktikantë për të dy sezonet. Për vitin 2021 kemi parashikuar nje mesatare prej 250 studentë.

Te ardhurat nga kuotat e antaresimit, per periudhen 9 mujore jane realizuar 62 %, të planit vjetor. Duke parë ecurinë e pagesave për periudhen tetor-dhjetor për vitet 2017-2019, mendojme se deri ne fund te vitit 2020 pritet te realizohet 100 % e planit vjetor si rezultat I rritjes kryesisht te te ardhurave nga kuotat vjetore dhe të ardhurave nga rilicensimet. Ketu do te ndikojte dhe nisma qe ka filliar kete periudhe per arketimin ritmik te te ardhurave, nisme qe per vitin 2021 do te jete prioritare. Per rrjedhoje, per vitin 2021 jane planifikuar 15 % me shume se planifikimi I vitit 2020.

Planifikimi I të ardhurave sipas peshes specifike te tyre, paraqitet si vijon:



Si shihet nga të dhënat peshen kryesore të të ardhurave e kanë të ardhurat nga kuotat e antarësimit, 61% të tyre, me pas te ardhurat nga tarifa e rilicensimit 13%.

Duke parë ecurinë e realizimit të të ardhurave në vite, për të mos planifikuar një buxhet fiktiv, të ardhurat në total janë parashikuar 9% me shume se parashikimi për vitit 2019, në shumën 42.000 mijë lekë . Realizimi I të ardhurave do të bëhet I mundur duke rritur bazën e antarëve që paguajnë detyrimet, duke evidentuar dhe monitoruar antarët që kanë vitin e rilicensimit dhe ata qe kane kaluar nje vit pa paguar detyrime si dhe duke formalizuar tregun e stomatologëve. Kjo do të arrihet me bashkëpunimin e të gjithëve, si të punonjësve të Aparatit Qendror, Sektorit Të liçensimit dhe Monitorimit, ashtu edhe të të zgjedhurve, në qendër dhe Rajone.


1.2 . SHPENZIMET

Shpenzimet për vitin 2021 janë planifikuar nisur nga realizimi I tyre në vitet paraardhëse si dhe efekteve te vendimeve te reja te Keshillit Kombetare. Per vitin 2021 kane efekte ne rritje te shpenzimeve zbatimi I dy vendimeve

- rritja e pagave te Aparatit Qendror
- rritja e fondit te investimeve per blerje.

Shpenzimet jane planifikuar sipas struktures ekonomike si dhe sipas shpërndarjes gjeografike.

Realizimi I shpenzimeve ne vite paraqitet sipas grafikut:



Megjithese nga viti ne vit shpenzimet jane ne rritje, kjo perkon edhe me shtimin e sherbimeve qe kryen Urdhri nga viti ne vit, duke filluar me provimin e praktikës profesionale në vitin 2016 me nje sezon, dhe ne vitet ne vazhdim me dy sezone, shërbimi I trajnimit ONL, rritja e sektorit te monitorimit dhe fillimi I konferencave informuese. Cdo sherbim qe shtohet shoqërohet me kosto financiare, por duhet theksuar se rritja e shpenzimeve eshte me e ulet se rritja e te ardhurave, duke mos krijuar humbje per asnje vit financiar.

Planifikimi I shpenzimeve paraqitet sipas tabelës:

Në 000 leke

N r	Emertimi	Fakti vitit 2019	Fakti 9 mujor 2020	I pritshm i 2020	Shpenzime Aparati Qendror	Shpenzime Rajone t	Planifikimi Viti 2021
1	Paga dhe shperblime	16000	10887	16000	17000	1370	18370
2	Fondi I veçante	800	618	800	850	70	920
3	Kontribut I sig shoqerore shendetesore	2387	1669	2660	2850	230	3080
4	Shperblime (honorare)	5213	4165	5600	1770	4450	6220
5	Mallra e sherbime	9090	5304	9360	7710	1500	9210
6	Investime	397	421	1000	13200	0	13200
	Shuma	33887	23064	35590	43380	7620	51000
7	Fondi rezerve	0	100	100	800	200	1000
	TOTALI	33887	23064	35520	44180	7820	52000


Ndarja e shpenzimeve sipas strukturës ekonomike paraqitet si vijon:

- 1. Shpenzimet e personelit** të cilat janë përcaktuar sipas nr. të punonjësve të miratuar në Këshillin Kombëtar dhe pozicioneve të tyre në strukturë. Në këtë zë përfshihen pagat, kontributi I sig. shoqërore e shëndetësore si dhe fondi I veçantë për punonjësit e Aparatit Qendror si dhe ne dy rajone. Per vitin 2021 eshte planifikuar rritje e shkallezuar e pagave per Aparatin qendror me vendim te Keshillit kombetare, I cili jep nje efekt prej 1950 mije leke ne fondin e pagave si dhe 300 mije ne kontributin per sig shoqerore
- 2. Shpenzimet operative** janë llogaritur për funksionimin normal të punës së administratës së Aparatit Qëndror dhe funksionimin e Rajoneve. Në këtë strukturë përfshihen shpenzimet për kanceleri, shtypshkrime, boj për printera, shpenzime për shërbime si energji, uje, telefoni, dieta, shpenzime financiare si qera, taksa, kuota pjesmarje në aktivitete etj. Ky zë është planifikuar 2% më pak se viti 2020 dhe duke përfshirë inflacionin shkon rreth 5-6 % me pak, duke ulur shpenzime per dieta, qera ambjente per aktivitete si dhe shpenzime pritje ne menyre te konsiderueshme, pasi do te kemi nje rritje ne shpenzime per ineres kredie.
- 3. Shpenzimet për honorare,** ku përfshihen shpenzimet për shpërblime të antarëve të Këshillit Kombëtar e Keshillave Rajonal si dhe komisioneve të tyre, shpërblimin për antarët e Asamblese Kombëtare e bordit keshillmor sipas miratimit të masës së shpërblimit nga Këshilli Kombëtar. Për vitin 2021 është

parashikuar nje rritje prej vitit 2020 per shkak te rritjes se numrit te antareve te keshillit kombetare dhe asamblese kombetare, rritjes se mases se shperblimit te antareve te K.Kombetare si dhe rritjes se nr, te mbledhjeve te K.Disiplinor..

- 4. Investimet** per vitin 2021 jane planifikuar ne shume te konsiderueshme, ne zbatim te vendimit te keshillit kombetare per blerje ambjente per zyra per USSH (Aparatin Qendror) Fondi eshte parashikuar ne shumen 13200 mije leke, 10000 mije perj te cilave do te perballohet nga te ardhurat e trasheguara dhe 3200 mije leke nga buxheti I vitit 2021.
- 5. Fondi rezervë,** I cili përcaktohet deri në 3% të shpenzimeve totale , dhe përdoret për shpenzime apo ngjarje të pa parashikuar dhe që mund të ndodhin gjatë vitit.Përdorimi I fondit rezervë do të bëhet me vendim të Këshillit Kombëtar.

Sipas strukturës te tyre shpenzimet ne menyre grafike paraqiten si vijon:



Si subjekt qe ka karakter administrativ, peshën kryesore në shpenzime e zënë shpenzimet për personelin (53%) e ndjekur nga shpenzimet per investime (25%) duke lene nje pasuri te patundshme per urdhrin.

Detajimi i Buxhetit të vitit 2021 sipas njesive administrative

Planifikimi I buxhetit sipas rajoneve është bazuar në këta faktorë:

- Detajimi dhe realizimi I buxhetit në vite nga Rajonet
- Struktura organizative e tyre sipas miratimit në Këshillin Kombëtar
- Zhvillimi I aktivitetit vendimarrës të këshillave rajonal
- Funksionimi I komisioneve disiplinore
- Perdorimi I fondeve të planifikuar per mallra e sherbime

Detajimi I buxhetit per vitin 2021 sipas ndarjes administrative do të mbetet pothuaj në nivelet e vitit 2020 dhe do te jete si vijon

Nr	Emertimi	SHUMA ne 000 leke
	SHPENZIME GJITHSEJ	52000
1	Aparati qendror	44180
2	Keshilli Rajonal Tirane	2100
3	Keshilli Rajonal Durres	985
4	Keshilli Rajonal Fier	945
5	Keshilli Rajonal Elbasan	950
6	Keshilli Rajonal Vlore	945
7	Keshilli Rajonal Lezhe	945
8	Keshilli Rajonal Shkoder	950

Struktura e shpenzimeve te Rajoneve sipas struktures ekonomike detajohet :

- honorare per Presidentet e rajoneve, sekretaret e tyre, keshillat rajonal si dhe komisioneve disiplinore.
- Paga për sekretaret e keshillave te emeruar rajonet Tirane dhe Durres
- Shpenzimet per blerje mallra e shërbime për shërbime administrative si dhe
- Fondi rezerve

Në zbatim të Ligjit nr.127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut” , rajonet do të miratojnë detajimin e mëtejshëm të buxhetit në Këshillat e tyre rajonal. Vendimi I miratimit të Buxhetit të vitit 2021 do të depozitohet në Aparatin Qendror për ndjekje të realizimit të Tij.

Buxheti rajonal është vjetor dhe nuk mbartet për vitin tjetër.

Teprica e buxhetit faktik te Urdhrit do të mbartet ne tepricën e viteve të mëparshme
Zbatimi I buxhetit do të bëhet sipas legjislacionit financiar në fuqi, Ligjit nr.127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut”, statutit të USSH-së dhe Urdhrave dhe Udhezimeve të Presidentit të Urdhrit.

Arkëtimet do të vazhdojnë të bëhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar, I vërtetuar me mandat arkëtimin e bankës.

Shpenzimet do të bëhen sipas procedurave të përcaktuara dhe të mbështetur në dokumenta standarte të miratuara për financat dhe për kontabilitetin Ndjekja dhe zbatimi I Buxhetit do të bëhet nga Aparati Qendror I Urdhrit dhe transfertat do te bëhen nen siglen e Presidentit te Urdhrit, I cili njihet si person juridik dhe është I regjistruar në organet tatimore.

Për detajimin e metejshëm të buxhetit në mënyrë analitike dhe zbatimin e tij, autorizohen Presidenti I Urdhrit dhe Presidentët e Rajoneve përkatësisht për buxhetin qendror dhe buxhetet respektive rajonale

Gjithë dokumentacioni për shpenzimet që do të realizohen do të depozitohet në sektorin Ekonomik për likujdim.

Keto ishin treguesit e buxhetit të vitit 2021.

Mendoj se treguesit e tij do të jenë realë dhe të realizueshëm . Gjatë vitit 2021 do të punohet për arketimin dhe miradministrimin sa më të mirë të tij dhe me efektivitet.

Ju ftoj të gjithëve për miratimin e Buxhetit të vitit 2021.

P/SEKTORIT EKONOMIK

Natasha DHRAMI